



Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën

Parimi: Identiteti i dëshmitarëve duhet të mbrohet

Studim i rasteve



Parimet për ballafaqimin me të kaluarën

Parimet për ballafaqimin me të kaluarën është një iniciativë qytetare, e promovuar nga koalicioni jo formal i përbërë nga 5 organizata dhe një eksperte: Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, Qendra Kosovare për Rehabilitimin të Mbijetuarve të Torturës, Integra, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, BIRN dhe Nora Ahmetaj. Grupi ka ndërmarrë një iniciativë të përbashkët për të hartuar dhe aprovuar një grup parimesh të cilat do të informojnë dhe udhëzojnë akterët politik dhe publik se si do të trajtojnë viktimat, të mbijetuarit/at, të kaluarën e dhimbshme dhe narrativat historike. Iniciativa ka për qëllim që të parandalojë diskursin dhe veprimet e dëmshme në lidhje me trashëgiminë e konfliktit dhe do të shërbejë si dokument referues, ku secili/a që shkel parimet e tij/saj duhet të mbahet moralisht përgjegjës. Andaj, qëllimi është që të aplikohen këto parime dhe të respektohen vlerat dhe ndjenjat që ato mishërojnë, në mënyrë që të sigurohet që viktimat dhe të mbijetuarit të mos dëmtohen dhe se veprimet që ndërlihen me ballafaqimin e të kaluarës do të kontribuojnë në procesin e pajtimit¹. Tani kur parimet janë zhvilluar e janë organizuar, gjithashtu edhe janë të shpjeguara mirë, ka një rëndësi kryesore që të prezantohen tek një publik i gjerë dhe të promovohen në mënyrë korrekte. Ne besojmë se një nga mënyrat për të bërë njerëzit të kuptojnë për rëndësinë e parimeve është të tregohet për dëmet, pasojat dhe dhimbjen, të cilat mund të shkaktohen në situatat kur parimet janë të shkelura. Prandaj koalicioni do të publikojë disa analiza të cilat do të përpilohen nga ana e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) dhe ne do të përpiqemi që të sjellim shembuj konkret nga e kaluara ku parimet janë përdorur në mënyrë të duhur apo edhe janë keqpërdorur. Një nga këto parime është “Identiteti i dëshmitarëve duhet të mbrohet”.

Identiteti i dëshmitarëve duhet të mbrohet

Shoqëria kosovare duhet të jetë shumë e kujdesshme ndaj rreziqeve të zbulimit të identitetit të dëshmitarëve në rastet që kanë të bëjnë me krimet e luftës. Masat mbrojtëse (afirmuese dhe ligjore) duhet të synojnë të kufizojnë ekspozimin e dëshmitarit ndaj kërcënimeve të mundshme dhe duhet të sigurojnë veprime të duhura (përshtatshme) ndaj kërcënimeve të jashtme.

Hyrje

Dëshmitarët janë subjekte sekondare të procedurës penale të cilët kanë parë ose kanë njohuri të caktuara në lidhje me një ngjarje dhe të cilët mund të konsiderohen si persona të besueshëm para gjykatës, e që kanë një rëndësi shumë të madhe sa i përket mbarëvajtjes dhe nxerrjes së verdiktit final në lidhje me një procedurë penale. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) konsiderohet se “si dëshmitar thirret personi për të cilin besohet se mund të jep informata për veprën penale, për kryerësin dhe për rrethanat e rëndësishme për procedurën penale².”

Sikurse edhe çdo subjekt tjetër në procedurë penale edhe dëshmitarët kanë të drejtat dhe detyrimet e tyre, në përputhje me legjislacionin penal në fuqi të Republikës së Kosovës. Dëshmitari ftohet nga gjykata, pasi që besohet se ai do të mund të kontribuojë në procedurë penale duke dhënë informata të rëndësishme për veprën e kryer penale, për kryerësin dhe për rrethanat e tjera të veprës penale. Prandaj duke u referuar në KPPRK “çdo person i thirrur si dëshmitar detyrohet t’i përgjigjet thirrjes, e kur me këtë Kod nuk është caktuar ndryshe, detyrohet edhe të dëshmojë³”, përpos në rast se ai lirohet nga detyrimi për të dëshmuar⁴.

Por përpos detyrimeve të cilat i ka një person në momentin kur ai caktohet si dëshmitarë në një procedurë penale, duke besuar se ka njohuri në lidhje me një ngjarje, ai gëzon edhe të drejtat e veta të cilat gjithashtu janë të përcaktuara me ligj. Ai ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga rreziqet të cilat mund t’i kanosen, si gjatë mbajtjes së shqyrtimeve gjyqsore të procedurës penale ashtu edhe nga kërcënimet të cilat mund të vijnë nga jashtë saj. Një dëshmitarë duhet të ndihet i lirë për të dhënë dëshminë e tij, pasi që në të kundërtën në qoftëse në të ushtrohet ndikim nga një person tjetër, atëherë dëshmia e tij mund të ndryshojë dhe në këtë mënyrë të jetë e padobishme për procedurën. Prandaj sidomos në raste të ndjeshme, ku

¹ Principi ALB (yih-r-ks.org)

² Kodi i Procedurës Penale, Neni 124, Paragrafi 1, Faqe 55, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

³ Kodi i Procedurës Penale, Neni 124, Paragrafi 36, Faqe 55, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

⁴ Dëshmitarët e privilegjuar dhe dëshmitarët e liruar nga detyrimi për të dëshmuar, Shiko në “Kodin e Procedurës Penale, Neni 126-127, Faqe 57, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>



dëshmitarët mund të kërkojnë që identiteti i tyre të mos jetë i njohur dhe në anën tjetër deklaratimet e tyre të bëhen në seanca pa prezencën e publikut, përkatësisht në seanca të mbyllura, vet gjykata konform ligjeve dhe dispozitave ligjore në fuqi, do të duhet që t'u ofrojë atyre siguri dhe mbrojtje.

Prandaj në një shoqëri demokratike përpos garantimit të gjykimeve të drejta dhe të paanshme, është më se e nevojshme që gjykata të kujdeset edhe për sigurinë e subjekteve në procedurë. Mbi të gjitha dëshmitarët të cilët paraqiten në rastet të cilat kanë të bëjnë me krimet e luftës, duhet të iu ofrohet mbrojtje adekuata nga kërcënimet eventuale ndaj tyre si rrjedhojë e dëshmitëve të cilat ata i japin para gjykatës. Andaj kur ndonjë dëshmitarë kërkon mbrojtje apo anonimitet të tij, gjykata do të duhet të i mbrojë ata përmes masave ligjore respektive për këto raste.

Gjatë zhvillimit të procedurës penale, dëshmitari mund të deklarohet publikisht para të gjithëve, apo varësisht nga ndjeshmëria e rastit dhe rreziku potencial të cilin mund ta ketë dëshmitari, ai mund të dëgjohet në seancë të mbyllur. Për këtë, dëshmitari në çdo fazë të procedurës mund të paraqesë kërkesë për masë mbrojtëse apo urdhër për anonimitet⁵.

Por edhe jashtë procedurës gjyqësore, në raste kur gjykata e konsideron të arsyeshme ose edhe në raste kur i cenohet siguria e dëshmitarit, atëherë mund të paraqiten masa të cilat edhe janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, ku dëshmitarëve mund t'u sigurohet mbrojtja e nevojshme në mënyrë që ata të dëshmojnë lirshëm dhe të mos ndihen të rrezikuar në jetën e tyre private. Kjo në të njëjtën kohë kontribuon edhe në një proces gjyqësorë shumë më efikas dhe të paanshëm.

Në Kosovë ekziston baza ligjore e cila parasheh përdorimin e masave mbrojtëse, nëse ekziston rreziku serioz ndaj një personi, apo të afërmeve të tij, i cili është i normuar nëpërmjet ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve⁶.

Andaj për ta arsyetuar rëndësinë e zbatimit të parimit të cilin po e shtjellojmë, në vazhdim kemi analizuar mënyrën se si është shkelur parimi i lartcekur, ku identiteti i dëshmitarëve ligjërisht të mbrojtur në procedurë penale, është ekspozuar në mënyrë krejtësisht jo të drejtë, duke e rrezikuar jetën dhe integritetin e tyre.

Ekspozimi i identitetit të dëshmitarit të mbrojtur

Raporti vjetor mbi gjykimet për krime lufte i përpiluar nga Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) më 2013, është titulluar “Dëshmitarët ende Thembra e Akilit në gjykimet e profilit të lartë⁷.” Emërtimi i këtij raporti ka ardhur si rezultat i vështirësive të cilat i janë shfaqur dëshmitarëve të ftuar për të dhënë dëshmitë e tyre në proceset gjyqësore të cilat janë mbajtur gjatë atij viti, ku edhe spjegohet se ata nuk kanë dëshmuar lirshëm, për shkak të frikës të cilën ata e kanë përjetuar apo edhe për shkak të presionit i cili është ushtruar ndaj tyre. Në këtë raport përshkruhet se si dëshmitarët kanë hequr dorë nga dëshmitë e tyre paraprake me të cilat e kanë mbështetur aktakuzën apo kanë refuzuar të jenë dëshmitarë të prokurorisë për shkak të ndikimit të ushtruar në ta⁸.

Po ashtu edhe raporti mbi progresin i Komisionit Evropian për vitin 2016 konstatoi se “sistemi i mbrojtjes së dëshmitarëve, me gjithë faktin se ka kapacitetet adekuata, për momentin nuk ka dëshmitarë nën mbrojtje për shkak të mungesës së besimit në këtë sistem⁹.”

Ndikim dhe ushtrim i presionit në dëshmitarë ka ndodhur edhe në dy rastet kryesore të cilat janë mbajtur gjatë vitit 2013. Ato kanë qenë aktakuzat e ngritura nga prokuroria kundër S.G. dhe të tjerëve dhe aktakuza tjetër në rastin “Drenica”, ku që të dyja rastet kishin të përbashkëta akuzat me të cilat të pandehurit akuzoheshin për kryerje të krimeve të luftës kundër popullsisë civile. Në të njëjtën kohë mbi bazën e këtyre akuzave të ngritura kundër tyre, S.G. dhe dy të bashkakuzuar të tjerë janë dënuar me aktgjykim dënues pikërisht për ato vepra, duke u bazuar në të gjitha provat dhe dëshmitë e mbledhura gjatë procedurës, ndërsa në rastin “Drenica” disa prej të pandehurve janë dënuar për akuzat me të cilat ngarkoheshin. Këto gjykime janë karakterizuar me një numër të madh të dëshmitarëve të cilët janë ftuar nga gjykata për të dhënë dëshmitë e tyre para gjykatës. Por jo të gjitha kanë shkuar ashtu siç ligjërisht do të duhej.

⁵ Kodi i Procedurës Penale, Neni 221, Paragrafi 1, Faqe 100, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

⁶ Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2758>

⁷ Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Raporti i vitit 2013, Faqe 8, <https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/2013.pdf>

⁸ Po aty, Faqe 8, <https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/2013.pdf>

⁹ Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Raporti i vitit 2016, Faqe 10, <https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/2016.pdf>



Si në rastin kundër S.G. dhe të tjerëve ashtu edhe në rastin “Drenica” është ekspozuar njëri prej emrave të dëshmitarëve kryesorë të këtyre rasteve.

Në gjykimin i cili është mbajtur kundër S.G. dhe të tjerëve për të vërtetuar fajësinë e të pandehurve, prokuroria kishte propozuar 6 dëshmitarë, prej të cilëve 4 kishin dëshmuar përmes video linkut, 3 nga të cilët në bazë të kërkesave të tyre janë mbajtur në kushte të mbylljes së plotë të shqyrtimit kryesor për publikun dhe në shqyrtim kanë qenë të pranishëm vetëm palët në procedurë¹⁰.

Si përfundim, në procedurën ankimore, gjykata kishte nxjerrë aktgjykim në lidhje me fajësinë e të pandehurve, ku secilit individualisht ia kishte shqiptuar dënimin me burgim në periudhë prej 8 viteve¹¹.

Gjatë kësaj periudhe kur edhe u mbajt shqyrtimi gjyqësor kundër S.G dhe të tjerëve, ishte ekspozuar identiteti i njërit prej dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria, e që njëkohësisht paraqitej edhe si një nga dëshmitarët kryesorë të ngjarjes. Ky dëshmitar me kërkesë të parashtruar në gjykatë, e kishte realizuar të drejtën e tij për t’u mbrojtur identitetin e tij në procedurë.

Përkundër faktit të kësaj kërkesë të miratuar nga gjykata me qëllimin që identiteti i tij të mbetet anonim, kishte ndodhur krejtësisht e kundërta. Kjo pasi që në mënyrë publike ishte ekspozuar identiteti i tij, me emër, mbiemër dhe me fotografi. Një gjë e tillë ishte bërë në qytetin e Skenderajit, vend në të cilin ishin vendosur disa afishe. Në këto afishe ishte përfshirë gjithashtu edhe një tekst në të cilin thuhej se “vetëm njerëzit e shitur si J.B. njollosin luftën e shenjtë të UÇK-së¹².”

Një veprim i tillë është i sanksionuar sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Duke e konsideruar se dëshmitari identiteti i të cilit ishte i mbrojtur, me publikimin e këtyre afisheve ishte cenuar siguria e tij. Për më tepër ai u shënjestrua si tradhëtar dhe i shitur.

Në anën tjetër sipas të dhënave të cilat kanë qenë të publikuara në media, supozohet që i njëjti dëshmitarë të ketë dëshmuar edhe në një rast tjetër në të cilin ishte ngritur një aktakuzë me pretendimet e kryerjes së krimeve gjatë kohës së luftës. Përkatesisht të pandehurit akuzoheshin për kryerje të krimeve kundër popullsisë civile. Ky rast për publikun njihet edhe si rasti “Drenica”, në të cilin gjithashtu akuzohej edhe kryetari i atëhershëm i komunës së Skenderajit, S.L.

Me rastin e nxerrjes së aktgjykimit të shkallës së parë, të datës 27 maj 2015, S.L. ishte shpallur fajtor për krimet me të cilat ai ishte ngarkuar, për të cilat gjykata i kishte shqiptuar dënimin me burgim në lartësi prej 12 viteve. Pas nxerrjes së këtij aktgjykimi, kishte filluar linçimi i një dëshmitari anonim, ku emri dhe mbiemri i të njëjtit ishte përmendur në mënyrë publike nga një familjare e të pandehurit S.L. Ajo në deklaratën e saj të cilën e kishte dhënë pas dënimit të S.L., e kishte konsideruar dëshmitarin si armik dhe misionar të Serbisë¹³.

Ndonëse si përfundim, Gjykata Supreme e kishte liruar të pandehurin nga akuzat me të cilat ai ngarkohej për kryerje të krimeve të luftës kundër popullsisë civile¹⁴, megjithatë ndikimi në dëshmitarë kishte qenë ekzistent gjatë zhvillimit të procedurës penale.

Veprime të tilla janë në kundërshtim të plotë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në të cilin një gjë e tillë inkriminohet në kuadër të veprës penale “Hakmarrja”. Në nenin 388 të këtij Kodi thuhet se “Kushdo që ndërmerr ndonjë veprim të dëmshëm për cilindo person me qëllim të hakmarrjes për shkak të raportimit apo të shpalesjes së informacionit për veprimet dhe mosveprimet që paraqesin kërcënim ose cenim të interesit publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet¹⁵.”

Zbulimi i identitetit të dëshmitarëve në këto raste të lartpërmendura dhe specifikuat personat të cilët e kanë kryer një veprim të tillë, kanë mbetur pa u hetuar/dënuar, gjë që jep mundësi të ripërsëritjes për shkak të pandëshkueshmërisë nga organet kompetente. Këto raste duhet të japin një alarm për hetuesinë, në mënyrë që të fillojnë procedurat në momentin e parë që shohin rrezikim të dëshmitarëve si dhe pengim të proceseve gjyqësore.

¹⁰ Po aty, Faqe 54, <https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/2013.pdf>

¹¹ Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, 29 tetor 2014, <https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/Sabit%20Geci%20at%20al/Sabit%20Geci%20at%20al-%20Aktgjykim-29102014.pdf>

¹² Kallxo.com, 08.06.2013, <https://kallxo.com/gjate/kundershtohet-zbulimi-i-identitetit-te-deshmitarit-te-mbrojtur/>

¹³ Telegrafi, 28.05.2015, <https://telegrafi.com/flet-gruaja-e-sami-lushtakut/>

¹⁴ Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Pasqyrë e gjyqësorisë për krimet e luftës në Kosovë në periudhën 1999-2018, Faqe 109, <https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/HLC-Kosovo-An-overview-of-war-crime-trials-in-Kosovo-1999-2018.pdf>

¹⁵ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 388, Paragrafi 2, Faqe 151, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>



Përpos inkriminimit të kësaj veprë të cekur më lartë, zbulimi i identitetit të dëshmitarit, që në procedurën penale do të thotë zbulim i identitetit dhe të dhënave personale të një personi të mbrojtur në procedurë penale, konsiderohet si veprë penale e cila është e dënueshme deri në 3 vjet burgim. Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, një veprim i tillë konsiderohet si shkelje e fshehtësisë së procedurës dhe që në nenin 392, paragrafin 2 të po këtij kodi thuhet se “Kushdo që pa autorizim zbulon të dhëna për identitetin apo të dhënat personale të personit të mbrojtur në procedurë penale apo në programin e veçantë të mbrojtjes, dënohet me burgim deri në tre vjet¹⁶.”

Kjo veprë gjithashtu ndikon në frikësimin e dëshmitarëve të tjerë potencial të cilët kanë njohuri për ngjarje të caktuara dhe të cilët do të hezitojnë të paraqiten për të dhënë dëshminë e tyre pranë gjykatës. Duke parë veprimet/kërcënimet të cilat janë ndërmarre ndaj një dëshmitari i cili duhet të ishte i mbrojtur, mund të ndikojë në tërheqjen e plotë të dëshmisë së tyre apo edhe në ndryshimin e asaj dëshmie. Një gjë e tillë paraqet ndikim direkt në administrimin e drejtësisë, e cila bën që drejtësia të mos arrihet.

Në lidhje me zbulimin e identitetit të dëshmitarit të mbrojtur, në kohën kur edhe kishte ndodhur ngjarja, kishte reaguar Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) me një komunikatë për shtyp. Sipas kësaj komunikate FDHK ka shprehur shqetësimin e tij në lidhje me publikimin e afisheve, fotografisë dhe mesazhit të cilin e përçonte një veprim i tillë, duke thënë se “Ky akt ekstrem rrezikon skajshmërisht jetën dhe sigurinë e personit që supozohet të jetë dëshmitar i mbrojtur në një gjykim për krime lufte, si dhe familjen e tij¹⁷.” Gjithashtu në këtë komunikatë i ishte bërë thirrje organeve kompetente që të gjinden sa më shpejtë personat përgjegjës për vendosjen e afisheve dhe të parandalohen veprimet e tilla për në të ardhmen.

Frikësimi dhe shtrëngimi i dëshmitarëve që të ndryshojnë deklaratat

Zbulimi i identitetit të dëshmitarëve nuk është defekti i vetëm i cili i ka përcjellë proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me krimet e luftës në Kosovë. Është identifikuar edhe frikësimi dhe shtrëngimi i dëshmitarëve që të ndryshojnë deklaratat e tyre, identiteti i të cilëve nuk është zbuluar.

Më datën 17 nëntor të vitit 2016 u ngrit aktakuza kundër të pandehurve E. Th. dhe të tjerëve ku, ndër të tjerash, disa prej të pandehurve akuzohen edhe për pengim dhe ndikim tek dëshmitarët e prokurorisë të cilat kanë dëshmuar në rastin e Drenicës, rast i cili është ende në gjykim. Pesë vite që nga ngritja e kësaj aktakuze ky rast ende nuk ka marrë as epilogun e shkallës së parë, gjë që mund të shpie në parashkrimin e veprës penale.

Parimi për mbrojtjen e identitetit të dëshmitarëve është i një rëndësie të veçantë për shkakun që ai ndërlidhet me mekanizmin e parë të drejtësisë tranzicionale e që i njëjti ka të bëjë me ndjekjet dhe gjykimet penale. Në kuadër të ndjekjeve penale përfshihen edhe çështjet në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, ku në të njëjtën kohë paraqet pengesën më serioze për ofrimin efikas të drejtësisë në gjykimet e krimeve të luftës. Ashtu siç edhe është specifikuar në “Manualin për Drejtësinë Tranzicionale¹⁸”, si pengesë kryesore në ndjekjen penale të kryesve të veprave penale paraqitet fakti i ndryshimit të deklaratave të dëshmitarëve për shkak të frikësimeve apo shantazhimeve ndaj tyre, e duke përfshirë këtu edhe dëshmitarët e mbrojtur.

Prandaj udhëzimi dhe rikujtimi i të gjithë personave në lidhje me të drejtat dhe detyrimet të cilat ata i kanë, paraqet një ndër parimet kryesore të procedurës penale dhe njëkohësisht i kontribuon vendosjes së drejtësisë, me theks të veçantë të krimeve të luftës.

¹⁶ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 392, Paragrafi 2, Faqe 153, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>

¹⁷ Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Facebook Post, <https://www.facebook.com/HLCkosovo/posts/345938155534472>

¹⁸ Manual për Drejtësinë Tranzicionale- Konceptet, Mekanizmat dhe Sfidat, Faqe 42-43, https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/Animacionet/hlc_tj_publication_final%2019.1%20MANUAL%20alb.pdf



Rekomandime

Në mënyrë që të ketë sa më pak raste të tilla në të ardhmen, në rend të parë rekomandojmë që “Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën¹⁹”, të respektohen dhe adaptohen nga të gjithë akterët politik dhe publik, e të cilët merren me trajtimin e së kaluarës.

Rastet gjyqësore që ndërlidhen me ndikim tek dëshmitarët (vepra penale e ndikimit në administrimin e drejtësisë) duhet të procedohen me urgjencë dhe vetëm në këtë mënyrë mund të krijohet një siguri apo një klimë e përshtatshme tek dëshmitarët. Zvarritja e procedurave gjyqësore të këtij lloji ndikojnë në humbjen e besimit të dëshmitarëve tek organet kompetente.

Në mënyrë që numri i personave të cilët e shkelin këtë parim të zvogëlohet, prokuroria duhet të nisë hetimet dhe të ngrisë aktakuza të reja ndaj personave të cilët publikojnë identitetin e dëshmitarëve.

Ky projekt implementohet me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Kosovë dhe Ambasadës Britanike në Prishtinë përmes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, dhe përmbajtja e përfshirë në këtë analizë nuk pasqyron pikëpamjet e tyre.

¹⁹ [Principi ALB \(yih-ks.org\)](http://PrincipiALB.org)

 **@dwpkosovo**

 **@dwpkosovo**

 **@dwpkosovo**

 **dwpkosovo**